

## **Edukimi i hershëm special (HFE)**

Edukimi i hershëm special është një masë e hershme për fëmijët nga lindja deri maksimalisht dy vite pas hyrjes në shkollë. Kjo ofertë ju drejtohet fëmijëve me anomali në zhvillim, si dhe fëmijëve zhvillimi i të cilëve është i rrezikuar. Anomalitë mund të tregohen në anën mendore, gjuhësore, motorike, emocionale, sociale dhe/ose në zhvillimin e përceptimit.

Me anë të sqarimit, me mbështetje preventive dhe edukative si dhe me ndihmë të përshtatshme, fëmijët përcillen dhe mbështeten në kontekstin familjarë.

Kohëzgjatja e edukimit të hershëm special rregullohet sipas nivelit të zhvillimit të fëmijës dhe të kërkesave të prindërve.